



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
eëë.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202301107/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandohet krijimi i ambienteve (dhomave) më vehte të intervistimit/marrjes në pyetje të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit, si dhe krijimi në çdo komisariat i dhomave për administrimin e provave materiale.*

Drejtuar: Drejtues Madhor Muhamet RRUMBULLAKU
Drejtor i Përgjithshëm
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

TIRANË

Drejues Tonin VOCAJ
Drejtor i Drejtorisë Vendore

TIRANË

Altin LILA
Shefi i Komisarariatit Nr.1

TIRANË

Loard Sallaku
Shefi i Komisarariatit Nr.2

TIRANË

Bledar RReshka
Shefi i Komisarariatit Nr.3

TIRANË

Sali SKURA
Shefi i Komisarariatit Nr.4

TIRANË

Oliger TORBA
Shefi i Komisarariatit Nr.5

TIRANË

Edvin NDREU
Shefi i Komisarariatit Nr.6

TIRANË

Kreshnik GJEÇKA
Shefi i Komisarariatit Nr.7

TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi inspektimet që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe Komisarariatet në varësi të saj.

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), në datat 20, 21 dhe 22 Nëntor, ka inspektuar Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë si dhe komisarariatet në varësi të saj. Inspektimet u kryen, duke u bazuar në faktin se:

1. Avokati i Popullit në vazhdimësi ka trajtuar ankesa të qytetarëve për keqtrajtime fizike ose psikologjike gjatë marrjes në pyetje të shtetasve në organet e policisë, ka një konstatim të vazhdueshëm se nuk janë respektuar të drejtat themelore të shtetasve të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë.
2. Referuar gjetjeve, në kuadër të vizitës së Delegacionit të Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore dhe Degraduese (CPT) të KIE-së, e cila ka zhvilluar vizitën e 7-të në vendin tonë nga data 04-15 Maj 2023, duke inspektuar/vizituar kushtet e ambienteve të institucioneve si dhe trajtimin e personave të privuar nga liria, në Policinë e Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Një nga gjetjet e CPT- në lidhje me inspektimet e kryera në organet e Policisë së Shtetit është fakti se: Janë marrë ankesa nga të paraburgosur se gjatë kohës që janë arrestuar/ndaluar e trajtuar në ambientet e Policisë së Shtetit, janë keqtrajtuar fizikisht nga punonjës të shërbimeve të policisë gjyqësore. Ndër këto konstatime janë:

Punonjës të strukturave për krimet, ushtrojnë dhunë fizike ndaj personave në hetim, si goditje me grushta e shkelma, për të marrë informacione dhe pohime lidhur me veprat penale.

Në një ankesë të marrë nga CPT¹ nga një person i paraburgosur është dhe fakti se specialistë të strukturave të hetimit të krimeve, ushtrojnë dhunë fizike duke goditur me shkop druri në pjesë të ndryshme të trupit personat në hetim në zyrat e punës së tyre (përfshi edhe shputat e këmbëve). Lidhur me këtë rast personi i arrestuar që gjendej në paraburgim (në I.E.V.P) i ka përshkruar delegacionit në mënyrë të detajuar ambientin/zyrën e policisë dhe vendin ku ndodhej shkopi i drurit me të cilin ai ishte dhunuar, i cili pas kontrollit/ vizitës së delegacionit është gjetur saktësisht në vendin ku është përshkruar nga i paraburgosuri.

Disa nga gjetjet e delegacionit është dhe fakti se nga inspektimi që është kryer në strukturat e Policisë së Shtetit është konstatuar se në zyrat e specialistëve për krimet/ oficerëve të policisë gjyqësore u janë gjetur të fshehur (në rafte/dollapë dhe mbi to) shkop druri/ shkop bejsbolli, të cilat mendohet se përdoren për ushtrim të dhunës fizike dhe psikologjike ndaj personave të dyshuar për vepra penale dhe personave që ndalohen/arrestohen nga këto struktura. Për këto raste, drejtues të strukturave për krimet dhe specialistët për krimet janë përpjekur të shpjegojnë dhe justifikojnë faktin se: “ato janë prova materiale të administruara në çështje penale”, duke ju dhënë dhe premtimin se do të largohen menjëherë nga zyrat/ambientet e punës. Në përfundim të vizitës Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore e Degraduese (CPT) të KIE-së, ka hartuar raportin me vëzhgimet dhe konkluzionet paraprake të cilat i janë përcjellë zyrtarisht nëpërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Avokati i Popullit në bazë të inspektimeve dhe monitorimeve të kryera në strukturat e policisë vlerëson se **autoritetet policore duhet të marrin masat e nevojshme për të luftuar të gjitha format e keqtrajtimit nga policia.** Të gjithë oficerët e policisë duhet të jetë të ndërgjegjshëm për të kuptuar se asnjë formë keqtrajtimi e personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar nuk është e pranueshme. Për këtë qëllim rëndësi duhet t'i jepet investimit në infrastrukturë të përshtatshme hetimi dhe në burime njerëzore të kualifikuara në mënyrë që të zvogëlohet mundësia e mbledhjes së të dhënave për kryerjen e një vepre penale nëpërmjet përdorimit të mjeteve të cilat shkaktojnë dhunë psikologjike dhe fizike ndaj qytetarëve që janë në konflikt me ligjin.

Nevojitet në vazhdimësi sensibilizimi i punonjësve të policisë në lidhje me efektet dhe pasojat e dhunës fizike dhe psikologjike mbi personat e shoqëruar/ndaluar/arrestuar, papajtueshmërinë në çdo rast të ushtrimit të dhunës mbi këta persona, e gjithashtu duhet të organizohen trajnime me punonjësit e policisë për njohjen dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, **si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend**, gjykon se bazuar në evidentimin e

¹Policehumanrightsresources.org/content/uploads/2016/06/CPT-Standards.pdf?x49094. CPT standards “Substantive” sections of the CPT’s General Reports. Nuk është e pazakontë që KPT-ja të gjejë objekte të dyshimta në ambientet e policisë, si prsh. shkopinj druri, doreza fshesash, shkopinj bejsbolli, shufra metalike, copa kablllo të trasha elektrike, imitim i armëve të zjarrit ose thikave. Prania e objekteve të tilla në më shumë se një rast ka dhënë hua besimi ndaj pretendimeve të marra nga delegacionet e KPT-së se personat mbaheshin në objektet janë janë kërcënuar dhe/ose goditur me objekte të këtij lloji.

problematikës të lartpërmendur, lind nevoja e një reagimi nga ana juaj për të garantuar përmbushjen e detyrimeve ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve të shoqëruar/arrestuar në ambientet e komisariateve të policisë dhe marrjen e administrimit e kallëzimeve/ankesave në përputhje me aktet normative në fuqi.

Ka një shqetësim të vazhdueshëm se brenda ambienteve të komisariateve ushtrohet dhunë psikologjike dhe se në raste të veçanta ka edhe pretendime për ushtrim dhune fizike.

Avokati i Popullit ka hetuar në vijimësi këto pretendime apo shqetësime publike dhe ka bërë rekomandimet përkatëse kur ka gjetur prova që demonstrojnë përdorimin e forcës tej limiteve të lejuara, në raste sporadike deri në dhunë fizike. Ndërkohë, përdorimi i dhunës psikologjike është tepër i vështirë për t'u provuar dhe për këtë funksionojnë vetëm masat parandaluese.

1.Një nga problematikat e evidentuara e cila është trajtuar edhe më herët nga Avokati i Popullit është mungesa e **dhomave të intervistimit/marrjes në pyetje të personit në cilësinë e të shoqëruarit, të arrestuarit apo të ndaluarit, brenda mjediseve të Policisë së Shtetit.**

- a) Në komisariatet e policisë në Tiranë, ka mungesë të dhomave më vehte për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar që duhet të ndërtohen në këto mjedise;
- b) Mungon instalimi i pajisjeve të sigurisë audio-vizive për të regjistruar procesin e marrjes në pyetje apo veprimeve të tjera procedurale hetimore me të shoqëruarit/arrestuarit/ndaluarit.

Në Procedurën Standarde të Punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, me Urdhërin: nr. 894, dt. 19.07. 2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit përcaktohet qartë se: *Pranë dhomave të shoqërimit dhe pjesë të këtij sistemi projektohen dhe ndërtohen ambiente të posaçme si: i.1 Dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar para se të akomodohen/futen në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë (personat që do të arrestohen/ndalohen).*

i.1.1 Ky ambient përveç kushteve të përcaktuara për dhomat e shoqërimit duhet të plotësojë dhe këto kushte:

Të ketë të instaluara tavolinë pune dhe karrige për oficerin e policisë gjyqësore dhe pajisje elektronike për dokumentimin e veprimeve procedurale që kryhen nga OPGJ (kompjuter, printer, letër, etj).

Tavolinë pune dhe dy karrige për qëndrimin e avokatit mbrojtës dhe të personit të dyshuar/akuzuar i cili do të intervistohet, arrestohet/ndalohet, etj.

Instalohen sisteme dhe pajisje për regjistrimin elektronik audio dhe video të të gjitha veprimeve procedurale që kryhen me personin e shoqëruar nga oficerët e policisë gjyqësore, para se personi të akomodohet në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë si i arrestuar/ndaluar.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personit në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.

Lidhur me këto fakte, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar² në mënyrë të përsëritur, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorive Vendore të Policisë, marrjen e masave për krijimin e zyrave të posaçme, për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse konstatohet nga inspektimet periodike të zhvilluara nga MKPT, ky rekomandim ende nuk është plotësuar.

Ndërkohë, vlerësojmë se në rastet e ndodhjes së ngjarjeve të rënda, si dhunime fizike, torturë apo të rasteve fatale të vdekjeve në ambientet e organeve të policisë, regjistrimi dhe ruajtja e filmimeve do të ishte një nga provat e rëndësishme për zbardhjen dhe identifikimin e autorëve të tyre. Me anën e regjistrimit audio-viziv mund të verifikohet dhe provohet nëse i arrestuari/ndaluari ka qenë ose jo i dhunuar para se të shoqërohej në organet e policisë, gjatë marrjes në pyetje para se të akomodohej në dhomat e sigurisë, apo është dhunuar brenda këtyre ambienteve, personat që e kanë takuar apo dhunuar, datën dhe orën e kryerjes së veprimeve të kundërligjshme, kryerjen e detyrave nga punonjësit e policisë të shërbimit të brendshëm, ofrimi i shërbimit mjekësor, etj. Për këto arsye, është domosdoshmëri monitorimi dhe ruajtja e regjistrimeve nëpërmjet të cilit do të mund të shmangen rastet e dhunës.

2) Gjithashtu është konstatuar se në shkelje të rregullave dhe procedurave të punës për administrimin e provave materiale të fiksuara gjatë procedimeve penale, në Komisariate ato mbahen në zyrat e punës së oficerëve të policisë gjyqësore, të pa paketuara/ambalazuara³.

² Rekomandohet krijimi i ambienteve (dhomave) më vehte të intervistimit/ marrjes në pyetje të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së shtetit. Nr.K4/189-2Prot, Dat. 28.12.2023.

³ Kodi i Procedurës Penale i Republikës Së Shqipërisë: Korrik 2017, Seksioni VII, "Provat Materiale", neni 187 Kuptimi i provës materiale (Ndryshuar me ligjin 9085, datë 19.6.2003), Prova materiale janë sendet që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale ose mbi të cilat gjenden gjurmë apo që kanë qenë

Avokati i Popullit i vë theksin faktit se është i rëndësishëm krijimi i dhomës së ruajtjes së provave materiale të fiksuara përgjatë procedimeve penale, e duhet të merret parasysh fakti që oficerët fillimisht është e nevojshme të heqin provat në një vend të sigurt, të përkohshëm (**dhomë depozitimi të provave**) që është e aksesueshme për oficerët në 24/7. Pas kësaj heqjeje fillestare nga zyrat e punës, provat janë të disponueshme vetëm për punonjësin i cili është i ngarkuar me funksionimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Legjislatori e ka theksuar rëndësinë e këtyrë veprimeve procedurale duke implementuar dispozita përkatëse në Kodin e Procedurës Penale në mënyrë që të zbatohen rigorozisht nga subjektet përkatëse që ligji i ngarkon.

Neni 214 i K.PR.Penale ka parashikuar shprehimisht:

Ruajtja e sendeve të sekuestruara

“1. Sendet e sekuestruara ruhen në sekretari. Kur kjo nuk është e mundur ose e përshtatshme, organi procedues urdhëron që ato të ruhen në një vend tjetër, duke përcaktuar mënyrën e ruajtjes.

2. Gjatë veprimit të dorëzimit, ruajtësi paralajmërohet për detyrimin e ruajtjes dhe të paraqitjes së sendeve kur kërkohen nga organi procedues, si dhe për dënimin e parashikuar nga ligji penal për atë që shkel detyrimin e ruajtjes. “

Neni 215 i K.PR.Penale ka parashikuar shprehimisht:

Vulosja e sendeve të sekuestruara (Shtuar pika 4, 5 dhe 6 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

“1. Sendet e sekuestruara sigurohen me vulën e organit procedues ose, në varësi nga natyra e sendeve, me mjete të tjera të përshtatshme që tregojnë se ato ruhen për nevojat e drejtësisë. Krijimi i dhomave të depozitimit të provave materiale është masë parandaluese e cila shmang aktet e mundshme të dhunës psikologjike/fizike që mund të kryhen nga punonjësit e policisë gjatë marrjes në pyetje të personave.

2. Organi procedues nxjerr kopje të dokumenteve dhe fotografi ose riprodhime të tjera të sendeve të sekuestruara që mund të ndryshojnë ose që ruhen me vështirësi, të cilat i bashkon me aktet dhe urdhëron ruajtjen e tyre në sekretari.

3. Për sendet që mund të ndryshojnë, organi procedues urdhëron, sipas rastit, tjetërsimin ose asgjësimin e tyre.

4. Me kërkesë të organit procedues, gjykata mund të urdhërojë asgjësimin e sendeve të ndaluara për t’u prodhuar, zotëruar, mbajtur apo tregtuar, në rast se ruajtja e tyre është e vështirë, veçanërisht e kushtueshme ose përbën rrezik për sigurinë, shëndetin apo higjienën publike. Në këtë rast, gjykata urdhëron marrjen e kampionëve dhe ruajtjen e tyre për qëllime të procedimit.

objekt i veprimeve të të pandehurit, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër, që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal, si dhe çdo send tjetër që mund të ndihmojë për sqarimin e rrethanave të çështjes.

5. *Organi procedues informon mbrojtësin e zgjedhur ose të caktuar kryesisht mbi vendin dhe datën e marrjes së kampionëve, të paktën 24 orë përpara. Mosparaqitja e mbrojtësit në marrjen e kampionëve nuk e ndalon organin procedues për marrjen e tyre.*

6. *Procedura për asgjësimin e sendeve të sekuestruara, afati, si edhe organi kompetent përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe Ministrit të Drejtësisë. Kur është e mundur, veprimet e kryera dokumentohen me mjete audiovizive dhe në çdo rast mbahet procesverbal, kopje e së cilit i dërgohet prokurorisë pranë gjykatës që ka vendosur asgjësimin.”*

Referuar parashikimeve të mësipërme ligjore, konstatohet lehtësisht detyra që ka vendosur legjislatori për krijimin e dhomave të depozitimit të provave materiale si një masë parandaluese për të shmangur aktet e mundshme të dhunës psikologjike/fizike që mund të kryhen nga punonjësit e policisë gjatë marrjes në pyetje të personave.

Nga verifikimet e kryera nga Avokati i Popullit nëpër institucionet e lartpërmenduar, është konstatuar se nuk është përmbushur ky detyrim ligjor, duke evituar në shkelje të ligjit aplikimin e një mase parandaluese që do të shmangte pasojat e ndodhura të reflektuara edhe në ankesat e vazhdueshme .

Problematikat që Avokati i Popullit ka konstatuar gjatë inspektimeve të tij apo verifikimeve të ankesave të shumta, kanë patur në fokusin e tyre respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga njëra anë dhe nga ana tjetër sigurimin e një procesi të rregullt ligjor i cili do t'i shërbejë mbrojtjes së individit në kuadrin e shtetit ligjor.

Situatat e konstatuara në këtë fushë janë kaq delikate dhe me pasoja shumë të rënda sa që legjislatori ka parashikuar evitimin edhe të dhënies së pëlqimit paraprak nga një person të cilit i është kufizuar liria, për të përdorur metoda ose teknika për të ndikuar mbi lirinë e vullnetit ose për të ndryshuar aftësinë e kujtesës e të vlerësimit të fakteve. Konkretisht ky parashikim procedural është në nenin 38 të K.PR.Penale, i cili parshikon se:

Neni 38 Rregulla të përgjithshme për marrjen në pyetje (Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. *I pandehuri, edhe kur është me masë sigurimi izoluese ose kur i është hequr liria për çdo lloj shkak tjetër, merret në pyetje i lirë, përveç rasteve kur duhen marrë masa për të parandaluar rrezikun e ikjes ose të dhunës.*

2. Nuk mund të përdoren, as me pëlqimin e të pandehurit, metoda ose teknika për të ndikuar mbi lirinë e vullnetit ose për të ndryshuar aftësinë e kujtesës e të vlerësimit të fakteve.

Disa nga gjetjet e inspektimeve tematike të Avokatit të Popullit në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe Komisaritet në varësi të saj për këto çështje, janë si më poshtë:

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë:

Në ambientin e sigurisë të DVP Tiranë ndodhet 1 dhomë intervistimi, e pajisur me orëditë e nevojshme si tavolina pune dhe karrige për qëndrimin ulur të personave, si dhe është e monitoruar me sistemin e kamerave.

Grupi i inspektimit monitoroi zyrat e punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore të krimeve në të cilat kryenin intervistat me personat gjatë procedimeve penale e në këto zyra gjendeshin prova materiale të cilat mund të ekspozonin dhunë tek personat. Gjithashtu evidentoi materiale të ndryshme që gjendeshin në korridoret e këtyre ambienteve.

Komisariati i Policisë nr.1

Në dhomat e shoqërimit të Komisaritetit të Policisë nr.1 Tiranë, nuk ka një dhomë më vehte të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/ marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë, për të cilët ekzistojnë kushtet e përcaktuara në ligj se ka dyshime të arsyeshme që kanë kryer një veprë penale. Në mungesë të kësaj dhome, këta persona merren në pyetje në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Nga inspektimi i zyrave të punës të oficerëve të policisë gjyqësore (zyra që shërbejnë edhe për marrjen në pyetje të personave), provat materiale të fiksuara gjatë procedimeve qëndronin në zyrat e tyre.

Në komisaritet gjendej një magazinë e cila shërbente për mbajtjen e materialeve të ndryshme si mjetet e punës së punonjësve të policisë, veshje, armë, objekte të nxjerra jashtë funksionit etj. Kjo magazinë nuk ishte ambient i duhur për ruajtjen e përkohshme dhe depozitimin e provave të fiksuara gjatë procedimeve penale.

Komisariati i Policisë nr.2

Në Komisaritetin e Policisë nr.2 Tiranë, **nuk ka një dhomë më vete të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/ marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë, për të cilët ekzistojnë kushtet e përcaktuara në ligj se ka dyshime të arsyeshme që kanë kryer një veprë penale.** Në mungesë të kësaj dhome, këta persona merren në pyetje në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Nga monitorimi që u bë zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore, u konstatua se provat materiale të fiksuara gjatë procedimeve penale qëndronin në zyrat e tyre.

Në komisarlatin e Policisë Nr.2 dhomat e sigurisë të cilat janë mbyllur me ndërtimin e bllokut të sigurisë në Tiranë, përdoren si magazine për administrimin e provave materiale dhe prova të cilat janë në sekuestro dhe nuk çohen në prokurori.

Komisariati i Policisë nr.3

Në Komisarlatin e Policisë nr.3 Tiranë, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Nga monitorimi që u bë zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë Komisarlat ishte një dhomë magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale, specialistja e magazinës që ndodhej në këtë ambient mbante të gjitha provat materiale të administruara gjatë procedimeve penale nga specialistët e krimeve si dhe materialet e tjera të ndryshme sipas regjistrave përkatës të ndarë më vehte për secilën kategori.

Komisariati i Policisë nr.4

Në Komisarlatin e Policisë Nr.4 oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore⁴.

Nga monitorimi që u krye në zyrat e punonjësve të policisë, u konstatua se provat materiale në këtë komisarlat mbaheshin në zyrat e punës së oficerëve të policisë gjyqësore. Magazina ndodhej në katin e parë të ndërtesës dhe kishte të administruara materiale të ndryshme por ishte e papërshtatshme për mbajtjen paraprake të provave materiale të administruara gjatë procedimeve penale.

⁴ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu, kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20].
<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806bf46f>

Komisariati i Policisë nr.5

Në Komisarlatin e Policisë nr.5 Tiranë, **nuk ka një dhomë më vete të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/ marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë, për të cilët ekzistojnë kushtet e përcaktuara në ligj se ka dyshime të arsyeshme që kanë kryer një vepër penale.** Në mungesë të kësaj dhome, këta persona merren në pyetje në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Nga monitorimi që u krye në zyrat e punonjësve të policisë, u konstatua se provat materiale në këtë komisarlat mbaheshin në zyrat e punës së oficerëve të policisë gjyqësore. Magazina ndodhej në katin e parë të ndërtesës dhe kishte të administruara materiale të ndryshme por ishte e papërshtatshme për mbajtjen paraprake të provave materiale të administruara gjatë procedimeve penale.

Komisariati i Policisë nr.6

Në Komisarlatin e Policisë nr. 6 Tiranë, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Nga monitorimi i zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Magazina në këtë komisarlat ndodhej në katin e parë të ndërtesës. Në të gjendeshin materiale të ndryshme si dhe prova të administruara.

Komisariati i Policisë nr.7

Në Komisarlatin e Policisë Nr.7 në Tiranë, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente nuk ishin të monitoruara me kamera, për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Nga monitorimi i zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Në përfundim të inspektimeve në Drejtorinë Vendore Tiranë dhe në Komisarlatet në varësi të saj, grupi monitorues konstatoi se ka prani të orendive, sendeve apo pajisjeve të tjera që mund të shkaktojnë presion apo dhunë psikologjike tek të

ndaluarit apo arrestuarit, të cilat mund të shërbejnë si mjet dhune gjatë intervistimit të personave në zyrat e punonjësve të policisë.

Një nga parimet e përgjithshme të përcaktuara në Konventat Evropiane, të OKB-së, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore për të drejtat e njeriut e në veçanti për ata persona që u privohet liria, ka të bëjë me trajtimin e të arrestuarve/ndaluarve në kujdesin dhe mbikqyrjen e punonjësve të Policisë së Shtetit, e cila duhet të jetë në përputhje me standardet e parashikuara në këto dokumente.

Ky parim është i shprehur më qartë në dispozitat e ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe konkretisht në procedurën standarde për trajtimin e sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, ku thuhet shprehimisht se: *“Punonjësi i policisë nuk duhet t’i shkaktojë të ndaluarit/arrestuarit keqtrajtim degradues fizik apo mendor, si dhe kërkon respektimin e të gjitha rregullave dhe procedurave përkatëse që kanë të bëjnë me ndalimin, arrestimin, marrjen në pyetje dhe trajtimin të tyre”*⁵.

Në këto kushte, Avokati i Popullit ka rekomanduar ndër vite organeve të policisë në nivel qendror dhe vendor, kryerjen e menjëhershme të projekteve të nevojshme dhe planifikimin e fondeve buxhetore, për ndërtimin e dhomave të intervistimit dhe marrjes në pyetje të personit të privuar nga liria, dhe dhënies fund të praktikës për marrjen në pyetje të personave shoqëruar ose arrestuar/ndaluar në zyrat e punës së oficerëve të policisë gjyqësore.

Në kartën e të drejtave që gëzojnë personat e shoqëruar/të arrestuar/të ndaluar, ndër shumë të drejta është edhe zhvillimi i një procesi të rregullt ligjor gjatë intervistimit apo marrjes në pyetje të këtyre personave nga punonjësit e policisë (specialist (OPGJ), ndihmës specialistë), i cili duhet të kryhet në ambiente (dhoma) të veçanta dhe pa praninë e asnjë personi tjetër, me sistem ajrosje dhe ndriçim të plotë natyral dhe artificial, të plotësuar me orenditë e nevojshme të punës dhe qëndrimin ulur të personave, si dhe të monitoruar nga sistemi i kamerave të sigurisë audio-vizive.

Në nenin 17 të ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, përcaktohet se një nga detyrat e policisë së shtetit është të parandalojë, zbulojë dhe të hetojë, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, veprat penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre. Ndaj, plotësimi i infrastrukturës dhe i kushteve në ambientet ku privohet liria e personit sipas kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi, përbëjnë kushtin material thelbësor si për kryerjen e veprimeve procedurale nga

⁵ *Kreu IV, pika 1 e procedurës standarde (Respektimi i të drejtave dhe lirive njerëzore), “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

punonjësit e policisë sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, por njëkohësisht dhe për garantimin e të drejtave të këtyre personave.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”:

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomave për depozitimin e provave materiale, të cilat duhet të administrohen dhe ruhen në ambiente/dhoma të ndara për këtë qëllim sipas rregullave e procedurave standarde.
2. Marrjen e masave për ushtrimin e kontrolleve në ambientet e zyrave të punës së specialistëve të krimeve dhe ndihmës specialistëve për policimin në komunitet-SPZ për heqjen e mos mbajtjen e sendeve e mjeteve që nuk janë pjesë e orendive/pajisjeve në inventar të tyre si “armë zjarri apo gjahu, shkopinj, leva e shufra hekuri, shkop bejsbolli, zinxhirë, doreza metalike” etj.
3. Marrjen e masave të nevojshme dhe të domosdoshme, për krijimin (ndërtimin) sa më parë brenda sistemit të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë të DVP. Tiranë dhe Komisariateve të policisë në varësi të saj, të dhomave më vehte për intervistimin apo marrjen në pyetje të personave të shoqëruar/arrestuar/ndaluar në mjediset e Policisë së Shtetit, të plotësuara me orenditë e nevojshme dhe të monitoruara me sistemin e kamerave audio-vizive, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.
4. Marrjen e menjëhershme të masave, që në projektet për përmirësimet e reja infrastrukturore në komisariate të ndryshme, të parashikohet në të tëra rastet dhoma e intervistimit si dhe dhoma për depozitimin e provave të përkohshme materiale të administruara gjatë procedimeve penale.

5. Marrjen e masave në vazhdimësi për sensibilizimin e punonjësve të policisë në lidhje me efektet dhe pasojat e dhunës fizike dhe psikologjike mbi personat e shoqëruar/ndaluar/arrestuar, papajtueshmërinë në çdo rast të ushtrimit të dhunës mbi këta persona, gjithashtu të organizohen trajnime me punonjësit e policisë për njohjen dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Ahmet PRENÇI